

Raportimi i qëndrueshmërisë: Rrjedhojat për sektorin publik dhe hapi pasardhës

12 nëntor 2025

Dmitri Gourfinkel dhe Sung-Jin Park



CFRR >>
Centre for Financial
Reporting Reform




Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR is an initiative of:



PULSAR is co-funded by:



Swiss Confederation
Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Struktura



PULSAR

KIPF KOREA INSTITUTE
OF PUBLIC FINANCE



Technical Note

**Sustainability Reporting: Implications for
Public Sector and the Next Steps**

CONTENTS

PËRMBATJA

Shkurtime	3
Falënderime	4
Parathënie	5
Përmbledhje e dokumentit	7
Kreu 1: Konteksti	11
Kreu 2. Zhvillimet më të fundit në kornizat e raportimit të qëndrueshmërisë.	13
2.1 Standardet e dhënës së sigurisë për sektorin publik në lidhje me Informacionet e qëndrueshmërisë	13
2.2 Standardet e dhënës së sigurisë për sektorin publik në lidhje me Informacionet e qëndrueshmërisë	22
2.3 Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të lidhura me Informacionet e qëndrueshmërisë	23
2.4 Korniza të tjera rregullatore që lidhen me informacionet e qëndrueshmërisë	24
Kreu 3. Përvojat e hershme në raportimin e qëndrueshmërisë në sektorin publik	27
3.1 Australia	28
3.2 Zelanda e Re	30
3.3 Zvicra	32
3.4 Britania e Madhe	33
Kreu 4. Rrjedhoja për sektorin publik dhe rekomandime.	35
4.1 Faza përgatitore	35
4.2 Faza e tranzicionit	38
4.3 Faza e shfrytëzimit	41
Kreu 5. Përfundime.	45
Bibliografia	46

Zhvillime të fundit në fushën e raportimit të qëndrueshmërisë

Përvojat e mëhershme në RQ në sektorin publik: Brazili, Zelanda e Re, Zvicra, Britania e Madhe

Rekomandime për vënien në zbatim të RQ-së në sektorin publik

Zhvillimi i kohëve të fundit në nivel ndërkombëtar



3

BSNKSP publikoi në tetor 2024 SRQ ED1, Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me klimën

- Standard i raportimit i sektorit publik mbulon
 - a) dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me klimën për operacionet e njësisë ekonomike dhe
 - b) dhënien e informacioneve shpjeguese për programet e politikave publike dhe rezultatet e tyre
 - Harmonizuar me konceptet e TCFD/SNRF S2 (drejtimi i brendshëm, strategjia, rreziku, treguesit matës/objektivat + Protokolli për gazet serrë)

BSNKSP vendosi ta ndante objektin e SNKSP SRQ ED 1 në dy standarde të ndara në qershor 2025

- Me renditje:
 - Faza 1: Operacionet e veta (miratimi pritet në dhjetor 2025)
 - Harmonizim më i ngushtë me standardin e sektorit privat (SNRF S2) për dhënien e informacioneve shpjeguese mbi rreziqet dhe mundësitë e njësisë ekonomike në lidhje me ndryshimet klimatike
 - Nuk do të përdoret më termi “Operacionet e veta” për të shmangur ngatërtime
 - Faza 2 Programet e politikave publike (që do të përgatiten në vitin 2026 si standard më vete)

Zhvillimi i kohëve të fundit në nivel ndërkombëtar



4

Paralelisht me ecurinë në vendosjen e standardeve të BSNKSP-së

- Standardi për dhënien e sigurisë (BSNAS)
 - BSNAS finalizoi SNSQ 5000 “Kërkesa të përgjithshme për angazhimet e sigurisë për qëndrueshmërinë” (publikuar më 12 nëntor 2024)
 - Një pikënisje e gjithanshme e përdorshme për të gjitha kornizat, në fuqi për periudhat që fillojnë më 15 dhjetor 2026 ose pas kësaj date
 - Grupi i Punës për Auditimin Mjedisor (GPAM) i INTOSAI-t nxori në shtator 2025 [Udhëzuesin për auditimin mjedisor]
 - Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistë (BSNEK) publikoi Standardet ndërkombëtare të etikës për dhënien e sigurisë për qëndrueshmërinë (SNEDHSQ) që hyjnë në fuqi për periudhat që fillojnë më 15 dhjetor 2026 ose pas kësaj date
- Standardet e edukimit (SNE-të e FNK-së)
 - Në mars 2025, FNK nxori rishikime të SNE 2, SNE 3 dhe SNE 4 në lidhje me qëndrueshmërinë, duke përfshirë kompetencat për analizën, raportimin dhe dhënien e sigurisë për qëndrueshmërinë në formimin fillestar profesional të kontabilistëve (me materiale mbështetëse zbatimi dhe afate kohore të ofruara nga FNK)


Zhvillimi i kohëve të fundit në nivel ndërkombëtar



5

Krahasimi i 4 vendeve: Brazili, Zelanda e Re, Zvicra, Britania e Madhe

- Faza të ndryshme të pjekurisë në RQ
- Siguron njohuri mbi përfshirjen e aspekteve të qëndrueshmërisë në raportimin financiar shtetëror



Përvojat e hershme në raportimin e qëndrueshmërisë në sektorin publik



6

Brazili

- *Instrumentet/praktikat aktuale:* Kuadri i Obligacioneve të Qëndrueshme Shtetërore (KOQSH)
 - Raportet orientuese për shpërndarjen e burimeve para emetimit dhe një raport për shpërndarjen dhe ndikimin në lidhje me emetimet e obligacioneve të qëndrueshme shtetërore
- *Objektivi & fusha e veprimit:* U sigurohet transparencë investitorëve për shpërndarjet e mundshme dhe rezultatet e raportuara; mbulon emetimet, përzgjedhjen e programeve/projekteve të lejuara, hollësitë e shpërndarjes dhe një listë jo-shteruese treguesish për kategoritë e ndikimit; përfshin nismat e fundit për qëndrueshmërinë
- *Baza dhe siguria rregullatore/qeverisëse:* Miratuar/publikuar nga Komiteti për Financa të Qëndrueshme Shtetërore (KFQSH, nëntor 2024); raportet dorëzohen për shqyrtim/verifikim të jashtëm lidhur me përfitimet mjedisore dhe sociale
- *Shpeshësia:* Raportet para emetimit i paraprijnë çdo obligacioni; raportet për shpërndarjen/ndikimin vijnë pas emetimit (ku KOQSH parashikon raportim vjetor të shpërndarjeve dhe ndikimeve)
- *Përse ky rast? :* Demonstron raportimin e “përdorimit të të hyrave” nga obligacionet e qëndrueshme shtetërore

Përvojat e hershme në raportimin e qëndrueshmërisë në sektorin publik



7

Zelanda e Re

- *Instrumentet/praktikat aktuale:* Analiza ekonomike dhe buxhetore për klimën (CEFA, 2023); standardet klimatike të publikuara nga Bordi i Raportimit të Jashtëm (XRB/BRJ) në zbatim të Ligjit për shtesa dhe ndryshime për sektorin financiar (aspekte të lidhura me klimën) 2021
- *Objektivi & fusha e veprimit:* CEFA informon vendimmarrësit për rrjedhojat ekonomike dhe buxhetore të ndryshimeve klimatike dhe për tranzicionin
- *Baza rregullatore/qeverisëse:* standardet e BRJ-së zbatohen kryesisht për njësitë e tregut financiar (private), mund të zbatohen për njësitë publike në tregje (p.sh., emetuesit); Ministria e Mjedisit po mendon kërkimin e dhënies së informacioneve shpjeguese nga ana e njësive publike
- *Bazat & faktorët shtytës të metodës:* CEFA mbështetet në klasat e rrezikut të TCFD-së (fizik dhe tranzicion), në Rrjetin për Sistemin Financiar të Gjelbër (promovon objektivin e Marrëveshjes së Parisit), në kornizën e Zyrës për Përgjegjësinë Buxhetore të Britanisë së Madhe (qëndrueshmëria buxhetore) dhe në Parimet e Helsinkit të Koalicionit të Ministrave të Financave për Veprimin Klimatik; faktorët shtytës përfshijnë Vlerësimin Kombëtar të Rreziqeve të Ndryshimeve Klimatike dhe pasojat nga rritja e raportuar nga sektori privat
- *Përse ky rast?:* Demonstron raportime të specializuara për klimën, që përqendrohen në rrjedhojat ekonomike/buxhetore

Përvojat e hershme në raportimin e qëndrueshmërisë në sektorin publik



8

Zvicra

- *Instrumentet/praktikat aktuale:* Raporti për Qëndrueshmërinë Buxhetore—seri afatgjatë që vlerëson qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike (2008, 2012, 2016, 2021, 2024) dhe që mbulon Konfederatën, fondet e sigurimeve shoqërore, kantonet dhe bashkitë; në mënyrë të nënkuptuar përputhet me UPR 1 për qëndrueshmërinë buxhetore afatgjatë
- *Objektivi & fusha e veprimit:* Llogaritë sasinë e barrës demografike; prej vitit 2021 përfshin vlerësim cilësor të efekteve afatgjata të klimës; Viti 2024 shton analizën e parë të ndikimit financiar të masave zbutëse, duke modeluar rrugëtimin drejt emetimeve neto zero deri në vitin 2050 dhe duke bërë parashikime për të ardhurat/shpenzimet, bilancin buxhetor dhe raportet e borxhit
- *Drejtimi i brendshëm / procesi:* Përfshirja e informacioneve për klimën ishte një vendim administrativ i Administratës Financiare Federale (jo një nismë formale politike); raporti lidhet ngushtë me planifikimin financiar afatmesëm dhe diskutohet në mënyrë aktive në komisionet parlamentare
- *Përse ky rast?:* Ilustron praktikën e raportimit të qëndrueshmërisë buxhetore afatgjatë dhe disiplinën e harmonizuar me SNKSP-të.

Përvojat e hershme në raportimin e qëndrueshmërisë në sektorin publik



9

Britania e Madhe

- *Instrumentet/praktikat aktuale:* Raporti vjetor për angazhimet e gjelbra të Qeverisë (AGJQ)—publikohet çdo vit nga DEFRA prej vitit 2012 për të paraqitur performancën mjedisore të pasurive dhe operacioneve shtetërore kundrejt veprimeve për AGJQ-të
- *Objektivi & fusha e veprimit:* Veprimet e dikastereve dhe organizatave partnere për të zvogëluar ndikimin në mjedis; zhvillimi i kornizës ka përfituar nga mbështetja/presioni i fortë politik dhe është ndikuar nga rritja e raportimit të qëndrueshmërisë në sektorin privat
- *Përse ky rast? :* Pasqyron përvojë të gjerë në harmonizimin me kriteret e kornizës për sektorin privat.

Rrjedhoja dhe rekomandime për sektorin publik



- Zhvillimi i standardeve ndërkombëtare dhe përvojave paraprake kombëtare ofrojnë informacione të vjera për rrjedhojat dhe rekomandimet e mundshme për RQ-në në sektorin publik.
- Këto rekomandime synojnë të mbështesin zbatimin me sukses të RQ-së në njësitë e sektorit publik, me theks të veçantë në këto fusha me rëndësi kritike: burimet dhe nevojat për ngritjen e kapaciteteve, mbledhja e të dhënave dhe vullneti politik.
- Këto grupohen edhe në tri tema të gjera: fazat e përgatitjes, tranzicionit dhe vënies në zbatim për të ofruar një qasje e strukturuar dhe me faza për të siguruar që njësitë e sektorit publik të mund të integrojnë me sukses raportimin e qëndrueshmërisë në sistemet e tyre të menaxhimit financiar, të përmirësojnë transparencën dhe të rrisin llogaridhënien për rreziqet dhe politikat e lidhura me klimën.

Rrjedhoja dhe rekomandime për sektorin publik



11

Rekomandime

Faza përgatitore

1. Të shqyrtohet SNKSP SRQ dhe literatura përkatëse, dhe të analizohen rrjedhojat
2. Të analizohen rregulloret ekzistuese që lidhen me qëndrueshmërinë
3. Të identifikohen institucionet kompetente për të çuar përpara ndryshimet rregullatore
4. Të kryhet një analizë e palëve të interesit dhe të përfshihen palët kyçe të interesit
5. Të merren masat për drejtimin e brendshëm
6. Të përcaktohet një metodë për futjen në zbatim
7. Të përzgjidhen njësitë pilot përkatëse
8. Të garantohet një qasje e drejtpeshuar për të vënë në zbatim SNKSP-të dhe SNKSP SRQ
9. Të vendosen piketat dhe një afat i reformës
10. Të sigurohet angazhimi i qeverisë përmes një vendimi për të filluar vënien në zbatim të raportimit të qëndrueshmërisë

Rrjedhoja dhe rekomandime për sektorin publik



12

Rekomandime

Faza e tranzicionit

1. Të vendoset një kuadër rregullator solid
2. Të sigurohet gatishmëri dhe mbledhje e të dhënave me cilësi të mirë
3. Të rritet angazhimi i palëve kyçe të interesit
4. Të integrohet raportimi i qëndrueshmërisë me PFQP-në
5. Të integrohet raportimi i qëndrueshmërisë me sistemet informatike
6. Të përcaktohen mekanizmat e llogaridhënies dhe të dhënies së sigurisë
7. Të shtrihet zbatimi pilot në njësitë e përzgjedhura
8. Të administrohet ndryshimi dhe të ngrihen kapacitetet
9. Të vendosen kanale komunikimi
10. Të sigurohen procese efektive monitorimi dhe vlerësimi

Faza e shfrytëzimit

1. Të vijohet përmirësimi dhe vlerësimi i procesit të reformës
2. Të shtrihet zbatimi përtej pilotimit
3. Të përdoren në vendimmarrje rezultatet e raportimit



CFRR >>
Centre for Financial Reporting Reform




Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR is an initiative of:



PULSAR is co-funded by:



Swiss Confederation
Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO